

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar, Afrim Shala dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.D., nga fshati Gadime e Epërme, Komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale vjedhje pylli, nga neni 358 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të pandehurit, e datës 19 mars 2018, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, P.nr.167/2017, i datës 15 shkurt 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 7 qershor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të pandehurit A.D., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, P.nr.167/17, i datës 15 shkurt 2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin A.D., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje pylli, nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 100 € (njëqind Euro), të cilin dënim, i pandehuri është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në të kundërtën dënimi me gjobë konform nenit 46 paragrafi 3 të KPRK, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për çdo 20 € (njëzet Euro) do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim.

Është detyruar i pandehuri A.D., që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë) Euro, si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë) Euro për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimin, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmarimit të dhunshëm.

Po ashtu është detyruar i pandehuri A.D., që Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Sektorit të Pylltarisë të Komunës së Lipjanit, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në vlerë prej 448 € (katërqindëzyzetetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i pandehuri A.D., për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza ose aktgjykimin të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/II.nr.361/2018, të datës 25 prill 2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të pandehurit, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatojë se :

- ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatojë se aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit.

Sa i përket vendimit për dënimin, në ankesën e të pandehurit A.D., theksohet se në seancën e shqyrtimit fillestar i njëjti e kishte pranuar fajësinë, gjithnjë duke patur parasysh faktin se nëse do të pranojë fajësinë gjykata do të ketë parasysh këtë fakt dhe do të i shqiptoj një dënim të arsyeshëm, me kusht apo vërejtje gjyqësore. Dënimin i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë dhe vlera e dëmit që duhet ta kompensojë i pandehuri është në disproporcion me peshën e veprës penale dhe pasojat e saj, duke patur parasysh faktin se i pandehuri e kishte pranuar fajësinë, se ishte penduar për këtë veprë penale, se bëhet fjalë për disa rrema të drunjëve. Duke patur parasysh edhe faktin se i pandehuri ka gjendje të varfër ekonomike dhe duke i marrë për bazë edhe rrethanat e tjera lehtësuese, siç është pranimi i fajësisë, dënimin i shqiptuar është në kundërshtim me qëllimin e dëimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të paraqitura në ankesën e të pandehurit janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dëimit, siç parashihet në nenin 73 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata e shkallës së parë e kishte marrë për bazë faktin se i pandehuri e kishte pranuar fajësinë, se i njëjti më parë nuk kishte rënë ndesh me

ligjin, është mbajtës i familjes dhe është i pa punë, ndërsa nuk kishte gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të njëjtin. Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit A.D. është në harmoni me peshën e veprës penale, me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Gjithashtu, edhe detyrimi për t'ia kompensuar dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar është në përputhje me ligjin dhe me gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, gjendje kjo e cila është vërtetuar pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, të datës 15 shkurt 2018. Andaj, duke i patur parasysh të gjitha këto që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se ankesa e të pandehurit për shqiptimin e një dënimi më të butë, është e pa bazuar.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.352/2018, Më 7 qershor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,
Hashim Çollaku

Biljana Rexhiq